

**PROGRAMI
MËSIMOR**



**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Viti II

Shkup, Qershor 2013

**SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
3 VJEÇARE**

I. HYRJE

(Të dhënat kryesore për lëndën mësimore)

Emërtimi i lëndës mësimore: Gjuhë shqipe dhe letërsi

Lloji i arsimit të mesëm: profesional

Viti i mësimimit të lëndës mësimore: Viti II

Numri i orëve të lëndëve mësimore:

- numri i orëve javore: **3 orë**
- numri i orëve vjetore: **108 orë**

Statusi i lëndës mësimore: e detyrueshme

II. QËLLIMI I LËNDËS MËSIMORE (nga viti I deri në vitin III)

Nxënësit/ nxënëset:

- të fitojnë njohuritë themelore (më të domosdoshme) nga lëma e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe botërore;
- t'i thellojnë njohuritë paraprake nga lëmi i gjuhës dhe letërsisë shqipe e botërore;
- të vetëdijësohen për rëndësinë e përvetësimit të mirë të gjuhës dhe letërsisë për karrierë dhe jetë të suksesshme;
- të aftësohen të komunikojë në shqipen standarde me gojë dhe me shkrim;
- të aftësohen për të komunikuar lirshëm me veprat letrare-artistike dhe për t'i komentuar/ analizuar ato;
- të aftësohet për mësim të pavarur...

III. QËLLIMET E LËNDËS GJATË VITIT MËSIMOR

Nxënësit/ nxënëset:

- të njihen me pasurinë e madhe leksikore të gjuhës shqipe;
- të dallojnë sinonimet, antonimet dhe homonimet;
- të dallojnë llojet e ndryshme të fjalëve;
- të aftësohen të përdorin fjalorë të ndryshëm;
- t'i njohin kategoritë gramatikore të mbiemrave dhe përemrave dhe t'i përdorin ato drejt...;
- të njihen me pjesët e ndryshueshme të ligjeratës... dhe drejtpërdorimin e tyre;
- të dallojnë fjalitë sipas qëllimit të thënies dhe përbërjes...;
- të njihen me gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë dhe me rendin e tyre në fjali;
- *
- të njihen me lëvizjen Rilindase dhe përfaqësuesit kryesorë të jetës kulturore të asaj kohe;
- të njihen me drejtimin letrar të romantizmit dhe me vijat dalluese të tij;
- t'i dallojnë tiparet romantike në veprat e Kristoforidhit, Veqilharxhit, Naimit, Pashko Vasës...;
- të njihen me kontributin kulturor e letrar të arbëreshëve të Italisë;
- të aftësohen të komunikojnë lirshëm me veprat e Jeronim de Radës, Zef Serembes, Gavrill darës...;
- të njihen me gjinitë dhe motivet kryesore letrare që kultivoheshin gjatë Rilindjes kombëtare;
- të njihen me tendencat e para të letërsisë realiste ndër shqiptarët;
- të bëjnë dallimin ndërmjet letërsisë romantike dhe asaj realiste;
- të njihen me autorët dhe kryeveprat letrare të Rilindjes evropiane;
- të njihen me kontributet e asaj periudhe për zhvillimet e mëvonshme në jetën kulturore dhetë gjitha sferat tjera të jetës...
- të njihen me disa prej kryeveprave të letërsisë romantike e realiste evropiane e botërore;
- të aftësohen të analizojnë dhe të kuptojnë mesazhet e veprave dhe fragmenteve të lexuara të autorëve të kësaj periudhe...

IV. QËLLIMET KONKRETE

Nxënësit/ nxënëset:

Fusha programore: GJUHË (54 orë)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat

- ta dallojnë fjalën si njësi më të vogël dhe të mëvetësishme të gjuhës, si njësi bazë e leksikut; - të njihen me përmbajtjen dhe formën e fjalës...	LEKSIKOLOGJI Fjala si njësi bazë e leksikut	- leksikologji - leksik	- Ushtrime leksikore për dallimin e përmbajtjes dhe formës së fjalës.
- të njihen me pasurinë e madhe leksikore të gjuhës shqipe (me kuptimet leksikore të fjalës)...	Kuptimi leksikor i fjalës	- kuptimi leksikor...	- Ushtrime për kuptimet leksikore të fjalëve...
- të dallojnë sinonimet, antonimet dhe homonimet...	Sinonimet, antonimet dhe homonimet	- sinonimet - antonimet - homonimet	- Ushtrime praktike për dallimin e sinonimeve, antonimeve dhe homonimeve...
- të dallojnë llojet e ndryshme të fjalëve;	Arkaizmat, historizmat, dialektizmat, krahinarizmat, neologjizmat, pofesionalizmat...	- arkaizmat - historizmat - dialektizmat - krahinarizmat - neologjizmat - pofesionalizmat	- Ushtrime për njohjen dhe dallimin më të mirë të llojeve të ndryshme të fjalëve...
- t'i njohin njësitë frazeologjike brenda teksteve të ndryshme; - të aftësohen t'i përdorin ato në të shprehurit e tyre me gojë dhe me shkrim...	Njësitë frazeologjike	- frazeologjizmat	- Ushtrime praktike për njohjen e frazeologjizmave të shqipes dhe kuptimin e tyre...
- të aftësohen të përdorin fjalorë të ndryshëm (drejtshkrimorë, shpjegues, dygjuhësorë, frazeologjikë, sinonimikë, fjalorë të fjalëve të huaja...)	Fjalorët – llojet e tyre	- fjalori	- Ushtrime për gjetjen më të lehtë të fjalëve të ndryshme nëpër fjalorë të ndryshëm.

- të thellohen njohuritë mbi foljen dhe llojet e ndryshme të saj...	MORFOLOGJI Llojet e foljeve (kalimtare e jokalmimtare...)	- foljet kalimtare - foljet jokalmimtare	- Ushtrime për dallimin ndërmjet foljeve kalimtare dhe jokalmimtare...
- të njihen me format e pashtjelluara të foljes – pjesoren, përcjelloren dhe paskajoren...	Format e pashtjelluara të foljeve	- format e pashtjelluara të foljes	- Ushtrime praktike për njohjen dhe përdorimin e foljeve të pashtjelluara...
- të njihen me kategoritë gramatikore të foljes...	Folja dhe kategoritë gramatikore të foljes	- kategoritë gramatikore	- Ushtrime për njohjen me kategoritë gramatikore të pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës...
- të njihen me mënyrat e foljes, veçmas me mënyrën dëftore dhe lidhore. - të aftësohen t'i mirëpërdorin foljet gjatë komunikimit të përditshëm verbal dhe me shkrim...	Mënyrat e foljes (mënyra dëftore dhe lidhore)	- mënyrat e foljes	- Ushtrime me tekst për njohjen e mënyrave të foljes...
- të njihen me kohët e foljes – mënyra dëftore dhe lidhore	Kohët e foljes (të thjeshta dhe të përbëra)	- kohët e foljes	- Njohja me kohët e foljes përmes ushtrimeve praktike në klasë dhe jashtë saj...
- të njihen me ndarjen e foljeve në zgjedhime; - të aftësohen t'i përdorin drejt foljet gjatë të folurit dhe të shkruarit...	Zgjedhimi i foljeve (vepror dhe jovepror)	- zgjedhimi vepror - zgjedhimi jovepror	- Ushtrime praktike për drejtëpërdorimin e foljeve në zgjedhime të ndryshme...

- t'i njohin kategoritë gramatikore të mbiemrave; - t'i përdorin drejt mbiemrat gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim...	Mbiemri dhe shkallët e mbiemrit	- mbiemri - shkallët e mbiemrit	- Ushtrime me tekst për njohjen e mbiemrit dhe kategorisë gramatikore të shkallës...
- t'i njohin kategoritë gramatikore të përemrave; - t'i përdorin drejt ato gjatë komunikimit me gojë dhe me shkrim...	Përemrat vetorë	- përemri - përemri vetor	- Detyra të zgjedhura e të kapshme për njohjen më të mirë të përemrave vetorë...
- t'i njohin dhe t'i përdorin drejt përemrat dëftorë...	Llojet e përemrave (dëftorë, pronorë, pyetës, lidhor, të pacaktuar)	- përemri dëftor - përemri pronor - përemri pyetës - përemri lidhor - përemri i pacaktuar	- Ushtrime rreth llojeve të ndryshme të përemrave dhe rolit të tyre në të shprehur...
- t'i njohin dhe t'i përdorin drejt ndajfoljet gjatë komunikimit...	Ndajfoljet	- ndajfolja	- Ushtrime për njohjen më të mirë të ndajfoljës...
- t'i njohin dhe t'i përdorin drejt pjesët e pandryshueshme të ligjeratës...	Parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, pasthirrmat	- parafjala - lidhëza - lidhëza - pjesëza - pasthirrma	- Ushtrime rreth pjesëve të ndryshueshme të ligjeratës dhe funksionit të tyre gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim...

- të dallojnë fjalitë sipas qëllimit të thënies dhe përbërjes...	SINTAKSA Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë.	- fjalia	- Ushtrime praktike për thellimin e njohurive mbi fjalinë...
- të njihen me gjymtyrët e dyta të fjalisë dhe me rendin e tyre në fjali...	Gjymtyrët e dyta të fjalisë	- gjymtyrët e fjalisë	- Ushtrime për njohjen e gjymtyrëve kryesore dhe të dyta të fjalisë...
- të njihen me rrethatorrin dhe me funksionin e tij në fjali... - të njihet me llojet e rrethatorëve (të kohës, të vendit, të mënyrës, të sasisë, të shkakut, të qëllimit...)	Rrethatorët dhe llojet e tyre	- rrethatori i vendit - rr. i kohës - rr. i mënyrës - rr. i sasisë - rr. i shkakut - rr. i qëllimit	- Ushtrime për njohjen dhe përdorimin e drejtë të rrethatorëve...
- të njihen me ndajshimin, llojet dhe me funksionin e tij në fjali...	Ndajshimi	- ndajshimi	- Ushtrime me tekst për njohjen dhe drejtpërdorimin e ndajfoljeve...
- të aftësohen të shfaqin origjinalitet dhe imagjinatë në të shprehur... - të njihen me mënyrat e shkrimit të hartimeve, me gjuhën më të përshtatshme për një hartim të suksesshëm; - të përdorin drejt shenjat e pikësimit; - të aftësohen të bëjnë renditjen logjike të gjërave dhe të përdorin shprehje sa më të kapshme e më të qarta...	Hartimet me shkrim Gjatë vitit do të bëhen 3 hartime	- Hartimi	- Ushtrime paraprake për shkrimin e bukur të hartimeve... - Biseda dhe analiza (me ndihmën e arsimtarit të këndës) të lektyrave të lexuara...
KOMUNIKIM			

<p>- do të aftësohen të ndihmojnë ose të marrin ndihmën e të tjerëve, në raste të caktuara, jo si një element mëshirimi (gjë që mund ta godasë e fyejë palën që tentojmë ta ndihmojmë...), por si një akt mirësjelljeje e si një obligim qytetar e qytetërues...</p>	Ofrimi dhe kërkimi i ndihmës	- ndihma	- Kjo fushë programore realizohet përmes metodash, formash e teknikash bashkëkohore të mësimdhënies, duke përdorur mjete adekuate mësimore dhe duke investuar në aftësimin e nxënësit për punë të pavarur në klasë dhe në shtëpi...
<p>- do të njihen me shokët dhe do të prezantojnë veten para tyre; - do të aftësohen të flasin me argumente për veten dhe për rrethin e tyre...</p>	Unë dhe të tjerët	- raportet në shoqëri	- duke përdorur mjete adekuate mësimore dhe duke investuar në aftësimin e nxënësit për punë të pavarur në klasë dhe në shtëpi... - Gjatë orëve të komunikimit (me gojë dhe me shkrim) arsimtari jep udhëzimet e duhura në momentin e duhur. Udhëzimet, këshillat, sugjerimet e tij janë gjithmonë në pajtim me njohuritë dhe aftësitë konkrete të nxënësve...
<p>- do të aftësohen të gjenden në raste konfliktesh e përplasjesh të interesave të kundërta; - do të aftësohen që konfliktet eventuale t'i bëjnë me taktin dhe sensin e duhur që nuk provokon efektin e kundërt nga ai i dëshiruari; do të ushtrohen që të jenë të drejtë në gjykime dhe të njohin mënyrat e zgjidhjes së konflikteve sipas traditave tona të bukura...</p>	Menjanimi i konflikteve	- konfliktet	- Gjatë orëve të komunikimit (me gojë dhe me shkrim) arsimtari jep udhëzimet e duhura në momentin e duhur. Udhëzimet, këshillat, sugjerimet e tij janë gjithmonë në pajtim me njohuritë dhe aftësitë konkrete të nxënësve...
<p>- do të aftësohen të flasin lirshëm mbi aktin e të lexuarit dhe mbi gjërat që i paraprijnë veprës së zgjedhur për lexim; - do të flasin për motivimin e lexuesit; për faktin se libri i zgjedhur për lexim duhet t'u përgjigjet aftësive intelektuale dhe paranjohurve të lexuesit...</p>	Leximi i një vepreje artistike	- leximi	- Gjatë orëve të komunikimit (me gojë dhe me shkrim) arsimtari jep udhëzimet e duhura në momentin e duhur. Udhëzimet, këshillat, sugjerimet e tij janë gjithmonë në pajtim me njohuritë dhe aftësitë konkrete të nxënësve...
<p>- do të aftësohen të ritregojnë ngjarje të</p>	Ngjarje të përjetuara	- përjetimet	- Gjatë orëve në fjalë arsimtari duhet të ketë kujdes

<p>përjetuara ose të dëgjuara prej miqve e shokëve; - do të ushtrojnë t'i paraqesin ngjarjet sipas etapave të ndodhisë, duke u përqëndruar në objektivitetin e tyre; - do të aftësohen që ngjarjen e ndodhur ta paraqesin në lidhje të ngushtë me kohën dhe vendndodhjen...</p> <p>- do të aftësohen të ritregojnë e të flasin mbi përmbajtjen e një filmi të shikuar...</p> <p>- do të aftësohen të kultivojnë sjelljen e mirë në punë e në jetë, qëndrimin e njerëzishëm, shpirtmirësinë, dashamirësinë; - do të aftësohen të sillen drejt edhe në situata të paprovuara më parë dhe të tregojnë mirësjellje ndaj rrethit të tyre të njohur e të panjohur (veçmas kur janë në situatë të reprezentuesve të kolektivit të tyre...).</p> <p>- do të aftësohen që të bëjnë një përshkrim të bukur të gjithë asaj që kanë përjetuar gjatë një pikniku në natyrë, duke dhënë në mënyrë sa më koncize tiparet e natyrës... e duke u ndalur në përjetimet më të këndshme dhe më të paharruara...</p> <p>Hartimi</p>	<p>Filmi</p> <p>Mirësjellja</p> <p>Përshtypjet nga pikniku</p> <p>Gjatë vitit do të bëhen dy hartime</p>	<p>- filmi</p> <p>- mirësjellja</p> <p>- pikniku</p> <p>- hartimi</p>	<p>maksimal që të gjithë nxënësit t'i aftësojë të komunikojnë sa më drejtë që mundën, me qëllim që nëser, kur t'i drejtohen tregut të punës, të jenë të aftë të komunikojnë me gojë dhe me shkrim me punëdhënësit e tyre, me kolëgët e punës dhe të përballen më lehtë me të gjitha situatat përpara të cilave mund të gjenden...</p> <p>- Edhe hartimi paraqet një formë të</p>
--	--	---	--

			komunikimit me shkrim, por është një obligim / detyrë ndaj së cilës nxënësi duhet të sillet në mënyrë shumë të përgjegjshme...
--	--	--	--

Fusha programore: LETËRSI (54 orë)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
- të njihen me lëvizjen Rilindase dhe përfaqësuesit kryesorë të jetës kuklturore të asaj kohe; - të njihen me letërsinë e Rilindjes - karakterin e saj patriotik, demokratik e iluminist...	Letërsia në periudhën e Rilindjes Kombëtare	- Rilindja Kombëtare	- Ushtrime për njohjen e të dhënave kryesore lidhur me Rilindjen kombëtare shqiptare...
- të njihen me drejtimin letrar të romantizmit shqiptar dhe me vijat dalluese të tij...	Romantizmi shqiptar...	- romantizmi	- Ushtrime rreth vijave dalluese të romantizmit shqiptar...
- të njihen me jetën dhe veprat letrare të shkrimtarit; - të aftësohen të komunikojnë lirshëm me letërsinë e tij duke vënë theksin në kryeveprën e tij: "Këngët e Milosaos"...	Jeronim de Rada	- letërsia arbëreshe	- Ushtrime përmes leximesh... për njohjen e letërsisë arbëreshe...
- të njihen me biografinë interesante të Serembes dhe me lirikën e tij...	Zef Serembe	- lirika	- Lexime poezishë të poetit në fjalë...

- të njihen me jetën dhe aktivitetin e bujshëm letrar të Naim Frashërit; - të lexojnë dhe analizojnë me ndihmën e arsimtarit kryeveprat e tij: "Lulet e verësë", "Bagëti e bujqësia" dhe "Historia e Skëndërbeut".	Naim Frashëri	- poema historike	- Ushtrime leximi dhe komentimi të teksteve të përzgjedhura të Naimit...
- të njihen me jetën dhe aktivitetin letrar të Pashko Vasës; - ta lexojnë dhe komentojnë romanin "Bardha e Temalit" dhe poezinë atdhetare "O moj Shqypni..."	Pashko Vasa	- romani - poezia atdhetare	- Lexime fragmentesh nga romani dhe poema e njohur e P. Vasës.
- të njihen me jetën dhe aktivitetin letrar të Çajupit; - të njihen me kryeveprën (veprën e parë të realizmit shqiptar) "Baba Tomorri"; - të dallojnë realizmin nga romantizmi dhe nga Rilindja kombëtare...	Andon Zako Çajupi	- letërsia realiste	- Ushtrime rreth dallimit të realizmit nga romantizmi...
- të njihen me autorët dhe kryeveprat letrare të Rilindjes evropiane; - të njihen me kontributet e asaj periudhe për zhvillimet e mëvonshme në jetën kulturore dhe të gjitha sferat tjera të jetës...	Letërsia në kohën e humanizmit dhe rilindjes (renesansës) evropiane	- Rilindja evropiane	- Shpjegime të rrethanave në të cilat u paraqit kjo periudhë letrare...
- të njihen me jetën dhe veprën letrare të Dante Aligierit; - të lexojnë e të komentojnë fragmente nga "Komedinë Hyjnore" me ndihmën e arsimtarit...	Dante Aligieri	- komedia...	- Lexime fragmentesh domethënëse nga kryevepra e gjeniut Italian...

- të njihen me jetën dhe aktivitetin letrar të Shekspirit; - ta lexojnë dhe analizojnë veprën “Romeo e Xhulieta”...	Uiliam Shekspiri	- tragjedia	- Ushtrime për njohjen më të mirë të tragjedisë si lloj i dramës...
- të njihen me jetën dhe kryeveprën e Servantesit „Don Kishoti i Mançes”...	Miguel de Servantesi	- romani aventuristik	- Njohja përmes leximit të fragmenteve dhe shpjegimit të arsimitarit të romanit aventuristik....
- të njihen me veprimtarinë letrare të Zhan Baptist Molierit dhe, përmes tij, me vijat dalluese të klasicizmit si drejtim letrar; - të lexojnë e interpretojnë (me ndihmën e arsimitarit) komedinë “Tartufi”...	Zhan Baptist Molieri	- klasicizmi	- Komentimi i komedisë “Tartufi” me ndihmën e arsimitarit...
- të njihen me krijimtarinë e Bajronit dhe, përmes tij, me fillet dhe karakteristikat e romantizmit evropian; - të lexojnë dhe komentojnë pjesë të zgjedhura të kryeveprës „Çajld Harold” (pjesët që kanë të bëjnë me ne shqiptarët...)	Xhorxh. Gordon Bajroni	- poema romantike	- Leximi i pjesëve të kryeveprës së autorit që kanë të bëjnë me shqiptarët...
- të njihen me veprën madhore të romantikut francez V. Hygosë; - të aftësohen të analizojnë veprën „Të mjerët”...	Viktor Hygo	- romantizmi evropian	- Shpjegime rreth karakteristikave të romantizmit evropian në raport me romantizmin shqiptar...

<p>- të njihen me veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe asaj botërore; - të aftësohet t'i vlerësojë anët pozitive të veprave letrare për nga përmbajtja dhe forma...</p>	<p>LISTA E LEKTYRAVE:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Jusuf Buxhovi - “<i>Shënimet e Gjon Nikollë Kazasit</i>“ 2. Dhimitër Xhuvani - “<i>E nesërmja e një gruaje</i>“ 3. Naim Frashëri - “<i>Historia e Skënderbeut</i>“ 4. Uiliam Shekspiri - “<i>Romeo e Gjulieta</i>” 6. Ymer Shkreli - “<i>Ura e Xhehenemit</i>“ 7. Zhan. B. Molieri - “<i>Tartufi</i>” 8. Ernest Koliqi - “<i>Tregtar Flamujsh</i>“ <p>Gjatë vitit duhet të analizohen 5 vepra nga lista e propozuar e lektyrave.</p>		<p>- Lexime dhe diskutime rreth veprave të lexuara – ngjarjeve, personazheve, tematikave të shtjelluara, mesazheve...</p>
---	--	--	---

I. UDHËZIMET DIDAKTIKE

Programi mësimor i lëndës ***Gjuhë shqipe dhe letërsi*** është përgatitur sipas kërkesave dhe metodave bashkëkohore, duke respektuar parimin e bashkëlidhjes (korelacionit) dhe integritit të dy fushave programore **Gjuhë** dhe **Letërsi**. Përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* (I-III) realizohen me anën e të dëgjuarit, të kuptuarit dhe të shprehurit (me gojë dhe me shkrim) të temave nga jeta e përditshme; me anën e të lexuarit dhe analizës së teksteve nga letërsia popullore dhe e shkruar, si dhe të teksteve me përmbajtje shkencore-popullarizuese dhe informative nga libri i leximit, revistat dhe nga burimet tjera. Në përmbajtjet e zgjedhura duhet të mbizotërojnë temat e mirësjelljes, të shoqërimit, të dashurisë, të punës, të gëzimeve të jetës, të paqes e lirisë, të bukurive të natyrës, të kujdesit ndaj ambientit jetësor etj.

Të gjitha përmbajtjet e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi* duhet të jenë në bashkëlidhje me përmbajtjet e lëndëve të tjera: me *gjuhën e huaj* (me qëllim të përvetësimit më të lehtë të terminologjisë, ligjeve dhe rregullave gramatikore të të dy gjuhëve); me lëndën e *historisë* (me qëllim të njohjes me zhvillimin historik të gjuhës, kur analizojnë, fjala vjen, këngë nga cikli i Gjergj Kastriotit, si figurë historike dhe si personazh letrar); me lëndën e *gjeografisë* (me qëllim të njohjes me dialektet e gjuhës shqipe); me *artin figurativ* (me qëllim të paraqitjes figurative të ngjarjeve dhe personazheve të teksteve të interpretuara letrare); me *artin muzikor* (me qëllim të përvetësimit më të mirë të njohurive mbi ritmin, rimën, figurat gjuhësore - asonancën dhe aliteracionin etj.).

Fusha programore *Letërsi*, bashkë me fushën programore *Gjuhë*, janë dy fushat kryesore në mësimdhënien e lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*.

Letërsia realizohet me leximin dhe përshkrimin e teksteve poetike, epike dhe dramatike, por dhe të teksteve me karakter fantastiko-shkencor dhe informativ, duke pasur gjithnjë parasysh karakterin e shkollës së mesme profesionale dhe rritjen e shkallëshkallshme të nivelit të njohurive të nxënësve...

Gjuha, ndërkaq, bashkë me nënfushën e komunikimit, përfshin çështjen e përvetësimit të gramatikës e të ligjshmërive të saj, të drejtshkrimit e të drejtshqiptimit, për aq sa është e nevojshme për nxënësit e shkollave të mesme profesionale.

Përmbajtjet e dy fushave kryesore programore dhe dy nënfushave (lektyrës dhe komunikimit, të përfshira në kuadër të tyre...) burojnë nga tekstet (artistike, gazetareske, shkencore, fantastiko-shkencore...) dhe ofrojnë mundësi për përvetësimin e të shprehurit dhe krijimtarisë (me gojë e me shkrim) në mënyrë sa më të pavarur e sa më funksionale.

Gjatë përgatitjes së planeve të punës arsimtari duhet t'i ketë parasysh kushtet që ofron shkolla (mjetet dhe pajisjet mësimore që ka në disponim) për realizimin e procesit mësimor, të përllogarisë me kujdes kohën e nevojshme (numrin e orëve) për arritjen e objektivave të caktuar dhe të përdorë metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies që do t'ia mundësojnë mbylljen e suksesshme të vitit shkollor.

I. STANDARDET E VLERËSIMIT

Nxënësit do të notohen në mënyrë permanente gjatë tërë vitit dhe përmes testimit ekstern.

Notimi permanent nënkupton vlerësimin e dijes dhe aftësive të nxënësit gjatë vitit shkollor. Për këto është paraparë vlerësimi/ notimi permanent në të dy semestrat.

Vlerësimi/ notimi i njohurive dhe aftësive konkrete të nxënësve duhet të jetë valid dhe i përgjegjshëm. Ai (vlerësimi/ notimi) duhet të bëhet përmes testeve, përgjigjeve gojore, punëve praktike...

Aspekti gramatikor dhe ai i drejtshkrimit të gjuhës vlerësohet përmes testeve dhe detyrave të kontrollit.

Në rast të mospjesëmërisë të nxënësit gjatë testimit, ata i nënshtrohen riprovimit.

II. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

NOTIMI DHE KONTROLLIMI DIAGNOSTIK

Në fillim të vitit mësimor arsimtari bën notim dhe kontrollim diagnostik, me qëllim të verifikimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve të fituara përgjatë vitit shkollor pararendës. Arsimtari mund ta realizojë këtë me ndihmën e instrumenteve të ndryshme: përmes testeve diagnostike, përmes fletëzave anketuese, përmes pyetjeve gojore të përgatitura e të mirëmenduara nga ana e tij, përmes shkrimit të teksteve të shkurta etj.

Rezultatet e fituara paraqesin pasqyrën e njohurive dhe aftësive konkrete të nxënësve dhe si të tilla shërbejnë edhe si pikënisje për planet e mëpastajme për realizimin e Programit mësimor dhe përparimin e procesit kompleks të vlerësimit gjatë vitit shkollor.

NOTIMI FORMATIV

Gjatë viteve mësimore preferohet edhe vlerësimi formativ që mundëson notimin më objektiv të arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe të caktuar. Këtë tip notimi arsimtari mund ta realizojë me shfrytëzimin e më shumë metodave të notimit:

- bisedave mes nxënësit dhe arsimtarit;
- prezentimeve gojore;
- hartimeve me shkrim;
- testeve;
- detyrave të shtëpisë.
- portfolieve – mbledhjes së treguesve për arritjet e secilit nxënës, siç mund të jenë krijimeve origjinale të nxënësve...

Portfoliet duhet të jenë të njohura për prindërit e nxënësve që edhe ata të mund të kontribuojnë në realizimin sa më të mirë të mësimin të lëndës *Gjuhë shqipe dhe letërsi*.

Portfoliet e nxënësit plotësohen me të dhëna gjatë viteve të ardhshme shkollore.

Këto metoda të notimit arsimtari mund t'i vlerësojë dhe t'i kontrollojë me lista të veçanta të evaluimit për çdo nxënës, të përgatitura paraprakisht, të cilat plotësohen me çdo aktivitet konkret. Rezultatet e fituara të arritjeve të nxënësve janë të arritshme për arsimtarët, nxënësit dhe prindërit e tyre.

NOTIMI SUMATIV

Në bazë të të dhënave të tërësishme të fituara nga ndjekja dhe kontrollimi i të arriturave të nxënësve gjatë periudhës së realizimit të Programit mësimor, arsimtari e konstaton përparimin e çdo nxënësi veç e veç, në kuadër të secilës fushë programore. Nga notat e formuara sumative, të formuluara për çdo nxënës, duke u udhëhequr gjithnjë nga nivelet e arritjeve, gjatë një periudhe të caktuar kohore, arsimtari vendos notat përkatëse numerike.

II. KUSHTET HAPSINORË PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Për të realizuar qëllimet e parapara me programin mësimor, lënda **Gjuhë shqipe dhe letërsi** duhet të realizohet në mësonjëtoare apo kabinete përkatëse...

Mjedisi i mësimdhënies duhet t'i ketë kushtet themelore për zhvillimin normal dhe aktiv të veprimtarisë mësimore. Orenditë e klasës të mund të zhvendosen me lehtësi për t'u përshtatur me aktivitetet dhe format e punës si dhe të mundësojnë komunikim aktiv dhe pa pengesa në relacionin nxënës-nxënës, nxënës-mësimdhënës. Kushtet hapësinore duhet të jenë në përputhje me Normativin për kushtet hapësinore të miratuar nga ana e ministrit të arsimit dhe shkencës me vendimin nr. 07-4061/1 të datës 31.05.2007.

III. NORMATIVI PËR KUADRIN ARSIMOR

Lëndën **Gjuhë shqipe dhe letërsi** në shkollat e mesme profesionale 3 vjeçare mund ta ligjërojnë mësimdhënësit që kanë kryer:

1. Fakultetin Filologjik, Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor)
2. Fakultetin Filozofik, Grupin e Gjuhës dhe letërsisë Shqipe (drejtimi arsimor)

IV. FILLIMI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR

Data e fillimit: *1.09.2013*

Përbërja e ekipit profesional

1. Nexhbedin Sulejmani - këshilltar pedagogjik, BZHA, njësia rajonale Kumanovë (koordinues)
2. Prof. dr. Fatmir Sulejmani - Ligjërues në Universitetin Shtetëror të Tetovës
3. Saranda Oamani - Lika - "Nikolla Shtejn" (shkolla e mesme medicinale, Tetovë)
4. Ajten Ajdini Kadriu - SHMQSH "Cvetan Dimov" Shkup

Nënshkrimi dhe data e miratimit të Programit mësimor

Потпис и датум на утврдување на наставната програма

Наставната програма по албански јазик за втора година на средното стручно образование со тригодишно траење, на предлог на Бирото за развој на образованието, ја утврди министерот за образование и наука

МИНИСТЕР,

Спиро Ристовски

Изготвил: Неџмедин Сулејмани, советник
Контролирал: Трајче Георгиевски, раководител на одделение
Одобрил: м-р Митко Чешларов, раководител на сектор
Директор: м-р Весна Хорватовиќ

РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА
Бр. 11-5490/1 од 01.10.2013 година
Скопје